



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

P. 323  
Dt. 10.08.2018

Vendim

Nr. 9, datë 10.08.2018

**Për themelimin e Librit të Artë të Meritës në Albanologji**

**Drejtuar:** *Seksioneve Shkencore, redaksive të revistave shkencore, sektorit të Botimeve Shkencore dhe Bibliotekës Shkencore, sektorit të Financës, sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve*

**Për dijeni:** *Asamblesë së ASH*

Në mbështetje të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 3, dhe neni 4 pika ç; të Statutit të Akademisë së Shkencave, neni 2, pika 11; të vendimit nr. 24, datë 22.12.2017 "Për shpalljen e konkursit për veprat dhe botimin më të mirë shkencor kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe kohës së tij"; me propozim të jurisë së ngritur për konkursin shkencor ndërkombëtar shpallur në nderim të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit dhe me pëlqimin e Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike:

1. Themelohet *Libri i Artë i Meritës në Albanologji*, kushtuar studiuesve vendës dhe të huaj me merita jetësore të pazëvendësueshme në dijet albanologjike;
2. *Libri i Artë i Meritës në Albanologji* të ketë formën e një kodiku në pergamenë, kopje unike me 300 fletë.
3. Përzgjedhja dhe shtimi i personaliteteve të shkencës albanologjike me merita jetësore në këtë dije të rregullohet me një akt të posaçëm të Akademisë së Shkencave.
4. Për administrimin e *Librit të Artë të Meritës në Albanologji* ngarkohen:
  - Seksioni i Shkencave Shoqërore e Albanologjike dhe juria e konkursit, për konceptimin teknik dhe përgatitjen e zërave që u takojnë studiuesve albanologë;
  - Sektori i financës për procedurat buxhetore.

-Ngarkohet sektori i bibliotekës shkencore dhe botimeve pranë Akademisë së Shkencave për administrimin dhe ruajtjen e këtij libri unikal.

5. Plotësimet e para dhe përrurimi i “*Librit të Artë të Meritës në Albanologji*” të bëhen në ditën e shpalljes së fituesve të çmimeve shkencore ndërkombëtare të konkursit të organizuar në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

6. Ngarkohet specialist i komunikimeve shkencore për njoftimin e këtij urdhëru dhe specialist I IT për publikimin e këtij vendimi në web dhe në rrjetet sociale të ASH-së.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR SHKENCOR**

**Akademik Vasil S. TOLE**

